REPUBLIC OF KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA / MINISTRY OF HEALTH
Njesia Org. / Org. Unit: 06 — Prot.: 05-5569
Nr.i faqeva / Br.stranica / No.pages: - 2 — Data / Datum / Date: 12/09/2023
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria –Vlada-Government***

***Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministryof Health***

**Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor / Departman za strateški razvoj zdravstva / Department of Strategic Health Development**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **PËR/ZA/TO:** | | Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë | | | |
| **CC:** | | Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm | | | |
| **NGA/OD/FROM:** | | Ass. Dr. Edmond Haliti, PhDc, FESC, Kryesues i BShS | | | |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | | Thirrje për ripërcaktimin e kandidatëve të papranuar nga kategoria e I-rë për vendet e mbetura pa plotësura sipas konkursit për Shkollim Specialistik të datës 11.05.23 dhe rezultateve përfundimtare të shpallura me datë 12.09.2023 | | | |
| **Nr. i zyrës:**<br>**Br. kancelarije:**<br>**Room No.:** | | **Lokacioni:**<br>**Kucni:**<br>**Extension:** | | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 12.09.2023 |

| | |
|---|---|
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION | ☐ |
| PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL | ☐ |
| PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE | ☐ |
| PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS | ☐ |
| A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS | ☐ |
| VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION | ☐ |
| SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED | ☐ |
| SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED | ☐ |
| SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN | ☐ |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION | ☐ |
| **AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE** | |

Të nderuar,

Në pajtim me **Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125** dhe **Udhëzimin Administrativ për shkollimin specialistik Nr.01/2023** (nenet 16, 17, 18), Bordi për Shkollim Specialistik (BShS) në përputhje me kompetencat e tij dhe kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara me konkursin e shpallur për Shkollim

Specialistik nga Ministria e Shëndetësisë me datë 11.05.23 dhe vendimit të Ministrit të Shëndetësisë me nr.05-2877 të po kësaj datë, u bënë thirrje kandidatëve që tashmë kanë aplikuar për kategorinë e I-rë sipas këtij konkursi e që janë rradhitur si jofitues në lëminë e tyre të përzgjedhur fillimisht sipas rezultateve përfundimtare të datës 12.09.2023 (që përfshinë korrigjimet teknike të datës 26.08.2023 me shkresën zyrtare nr 05-4554 si dhe vendimet ë Komisionit të Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë), që të ripërcaktohen sipas preferencës së tyre në lëmitë/vendet e mbetura të paplotësuara nga raundi i parë, sipas tabelës më poshtë:

| **Lëmia specialistike** | **Titulli paraprak** | **Institucioni** | **Numri i vendeve të mbetura** |
|---|---|---|---|
| Mjekësi Emergjente | MD | ShSKUK | Total 5, sipas shpërndarjes: SP Ferizaj 2, SP Gjakovë 1, SP Gjilan 1, SP Pejë 1 |
| Anesteziologji me Mjekim Intenziv | MD | ShSKUK | Total 2 sipas shpërndarjes: SP Gjakovë 1, SP Mitrovicë 1 |
| Transfuziologji | MD | ShSKUK | Total 6, sipas shpërndarjes: Mitrovicë 1, Vushtrri 1, Pejë 1, Gjilan 1, Gjakovë 1, Prizren 1 |
| Fiziatri | MD | ShSKUK | Total 1, sipas shpërndarjes: SP Pejë 1 |
| Epidemiologji | MD | IKSHPK | Total 5, sipas shpërndarjes: ISHP Gjilan 1, ISHP Ferizaj 1, ISHP Mitrovicë 1, ISHP Pejë 1, ISHP Gjakove 1 |

**Aplikantët e papranuar nga raundi i parë dhe kategoria e parë e konkursit**, të cilët do të lajmërohen me **kërkesë me shkrim** në zyrën e administratës së Bordit për Shkollim Specialistik (011) në Ministrinë e Shëndetësisë **brenda 6 ditëve kalendarike në vijim (deri me datën 18.09.23, ora 15:00)** do të shqyrtohen duke u rradhitur sipas sistemit të njëjtë të pikëve të grumbulluara (i pari përzgjedhë) brenda kategorisë dhe lëmisë së njëjtë.
Pas procesit përzgjedhës, aplikantët fitues lidhin kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionin publik shëndetësor të listuar mbështetur në dispozitat e UA për shkollim specialistik 01.2023.
Kërkesat e pas-afatshme nuk do të shqyrtohen.

Me respekt

Bordi Qendror për Edukim Specialistik Pas Diplomik (BQESP)
Adresa: Rr/UI/St Zagreb pn/bb/nn, Lgj Arbëria -10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon : 038 212 114; Fax:: 038 212 233
http://www.mshgov-ks-org, E-mail: fahrije.marovca@rks-gov.net